

**SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ELITE URBAN DEVELOPMENT SH.P.K.**
Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me
NUIS L62423019U
Ruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, kat 4, Ap 26, Tirane

VENDIM

I
ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më datë 21.06.2022 (dy mijë e njëzet e dy), në orën 10.30, në selinë e Shoqërisë Elite Urban Development Sh.p.k me NUIS **L62423019U** (më tej referuar si "SHOQËRIA"), u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

- **Shoqëria "Tirana Logistic Park" Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Autostrada Tiranë – Durrës, Km. 5, Rruga "Gryka e Kaçanikut", mbrapa fabrikës Coca - Cola, Kamëz, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K81715012B, përfaqësuar nga administratori Znj. Irla Xhahysa, shtetase shqiptare, lindur në Kavajë, më 01.09.1991, me numër personal J15901111E, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, Ortak e Vetme e Shoqerise, zoteruese e një kuote qe perben 100% te pjesemarrjes ne Shoqeri.

Kryetari i Asamblesë znj. Irla Xhahysa deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrin e dyte të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

- I. **ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË;**
- II. **TE NDRYSHME;**

I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm parashtron se Kapitali aktual i Shoqërisë është 1.387.258.878 (Një miliardë e treqind e tetëdhjetë e shtatë milion e dyqind e pesëdhjete e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë lekë), përmotive operacionale është parë e arsyeshme zvogëlimi i tij me 443.000 EUR (Katërqind e dyzet e tre mijë euro) ose kundërvlepta ne 52.987.230 LEK (Pesëdhjëtë e dy milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë lekë).

Pas një shqyrtimi të kujdeshëm të çështjes së parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOS:

- A. Të miratojë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë me 52.987.230 LEK (Pesëdhjëtë e dy milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë lekë)
- B. Kapitali i ri i shoqërisë do të jetë 1.334.271.648 LEK (Një miliardë e treqind e tridhjetë e katër milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë lekë);

C. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme online me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqenëse nuk ka çështje të tjera për diskutim, Ortaku i vetëm deklaron të mbyllur mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në orën 11:00.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

ELITE URBAN DEVELOPMENT SH.P.K

Me ortak te vetëm

TIRANA LOGISTIC PARK SH.P.K.

Irla Xhahysa



The image shows a handwritten signature in blue ink that reads "Irla Xhahysa". This signature is placed over a printed name "TIRANA LOGISTIC PARK" which is underlined. Below the underlined name is the text "NUIS: K 81715012 B".